

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësi Ramë Hyseni, si kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Gani Avdiu dhe Mediha Jusufi, si anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses NTP “...” nga Ferizaji të cilin e përfaqëson S.S., kundër të paditurit F.Sh., nga fshati ... Komuna e Ferizajit, për shkak të Kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës të paditëses, të ushtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës Komonale në Ferizaj, C.nr.106/2007 të datës 24.10.2012, në seancën jo publike të mbajtur më dt. 23.08.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditëses NTP “...” nga Ferizaji, dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi Gjykatës Komonale në Ferizaj, C.nr.106/2007 të datës 24.10.2012, në pikën II dhe III të dispozitivit.

II.Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Komonale në Ferizaj, C.nr.106/2007 të datës 24.10.2012, në pikën I të dispozitivit – në pjesën aprovuese, mbetet i pa prekur.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar në pikën I të dispozitivit pjesërisht është aprovuar kërkesëpadia e paditëses dhe është detyruar i padituri që paditëses ti paguan shumën prej 175,00 € në emër të kompensimit të dëmit për shkak të dëmit të shkaktuar me datë 15.07.2012, nga goditja me automjet në shtyllën elektrike, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankë për një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data 19.02.2007 e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Në pikën II të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia e paditëses kundër të paditurit në pjesën tjetër të kërkesëpadisë në shumën prej 1.220,00 € për kompensimin e dëmit për shkak të dëmit të reklamës si e pabazuar. Në pikën III të dispozitivit është vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësja përmes të përfaqësuesit të saj në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, për shkak të konstatimit të gabarit dhe jo të plot të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar dhe ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses në pjesën refuzuese.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 194 të LPK Gjykata e Apelit e Kosovës, ka vërtetuar se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja NTP "... " nga Ferizaji, ka ushtruar padi kundër të paditurit F.Sh., nga fshati ... Komuna e Ferizajit, për shkak të kompensimit të dëmit, me të dhëna si në petitumin e kërkesëpadiisë si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata në procedurën e provave ka bërë nxjerrjen e provave përmes ekspertizës të ekspertit financiar E.P., si dhe i ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve A.L. dhe R.S. dhe pas vlerësimit të njëjtave në kuptim të nenit 8 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar dhe e ka aprovuar kërkesëpadinë si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar ndërsa pjesën tjetër e ka refuzuar këtë me arsyetim se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestues fakti se i padituri me automjetin e tij pasi e ka humbur kontrollin me datë 15.07.2007 e ka goditur shtyllën elektrike, në të cilën ka shkaktuar dëme të cilat i ka pranuar vet i padituri por ka qenë kontestuese lartësia e dëmit të shkaktuar, ndërsa gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadiisë është bazuar në ekspertizën e ekspertit financiar të cekur më lartë në bazë të cilit lartësia e dëmit në shtyllën elektrike ka qenë në shumë prej 175,00 €, e këtë gjykata e ka bazuar në dispozitën e nenit 185 par.1.3 dhe 4 të LMD-së, ndërsa gjykata sa i përket dëmit të pretenduar se është shkaktuar në reklamën e pompës të paditëses nga i padituri kërkesëpadinë në shumë prej 1.220,00 € e ka refuzuar si të pabazuar padi që paditësi pretendimet e tij nuk e ka mbështetur në prova konkrete bazuar në dispozitën e nenit 319 parag. 1 të LPK-së në bazë të së cilës secila palë ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i mbështet kërkesat dhe pretendimet e veta, si dhe dispozitën e nenit 322 të LPK-së, e që në rastin konkret gjykata ka konsideruar se paditësi nuk ka arritur që të provoj pretendimet e veta në raport me të paditurin për dëmin e shkaktuar në reklamë dhe për këtë arsye edhe e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses.

Kjo gjykatë, duke e vlerësuar përfundimin dhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se i njëjti është i drejtë, i bazuar, se ka mbështetje në dispozitat ligjore si dhe në shkresat e lëndës, ndërkohë që janë dhënë edhe arsyet e justifikueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Pretendimet ankimore të paditësit, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilën kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e në anën tjetër paditësja siç u cek edhe më lartë në arsyetim të këtij aktgjykimi, nuk ka arritur që me prova të provoj se i padituri i ka shkaktuar dëm me automjetin e tij edhe në reklamën e vendosur nga ana e paditëses.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në pikën I të dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 195.1 nën d) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit gjykata vendosi që pjesa aprovuese të mbetet e pa prekur pasi që në këtë pjesë nuk ka pas ankesë.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.44/2013 më dt. 23.08.2016

Kryetari i kolegjit,
Ramë Hyseni,

SHËNIM MBI VOTIM DHE VENDOSJE

Një zërit u vendos, në seancën jo publike të kolegjit të mbajtur më dt. 23.08.2016, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Referues ka qenë gjyqtari Ramë Hyseni.

Vërtetojnë:**Anëtarët e kolegjit****Kryetari i kolegjit**

1. _____

2. _____